<p style="text-align: center;">Neni 14 Parandalimi i rrezikut te përhapjes se sëmundjeve</p> <p>Gjatë aktit të transplantimit të organeve ose pjesëve të tyre, Qendrat transplantuese janë të obliguara të marrin të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të evitojnë ose të zvogëlojnë rrezikun e bartjes së sëmundjeve infektive ose çfarëdo sëmundjeje tjetër të marrësi dhe dhuruesi i organit si dhe që mund të ndikojnë në kualitetin e organit të hequr.</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Prevention of the disease spreading Risk</p> <p>During the transplantation of organs or parts of organs, the transplantation centers are obliged to undertake all necessary measures in order to avoid or decrease the risk of transmitting contagious diseases or any disease to the recipient and the donor of the organ and that may have an impact to the quality of the removed organ.</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Sprećavanje opasnosti proširenja bolesti</p> <p>Tokom aktivnosti trasplantacije organa ili njihovih delova, centri za trasplantacije obavezni su da preduzmu sve potrebne mere kako bi otklonili ili umanjili opasnot prenošenja infektivnih bolesti ili bilo koje druge bolesti kod davaoca ili primaoca organa i koji mogu da utiću na kvalitet uklonjenog organa.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 15 Financimi i transplantimit te organeve</p> <p>Për të gjitha veprimet që bëhen gjatë aktit të transplantimit, si dhe për përcjelljen e gjendjes para dhe pas transplantimit tek dhuruesi dhe marrësi, mjetet financiare sigurohen konform bazës ligjore në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Organ transplantation financing</p> <p>The financial means for all the activities undertaken during the transplantation act, as well as for the supervision of the condition before and after the transplantation to the donor and recipient shall be secured in conformity with the legal grounds in power.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Finansiranje postupka transplantacije organa</p> <p>Za sve radnje koje se vrše tokom postupka transplantacije, kao i za praćenje stanja davaoca i primaoca pre i posle transplantacije, finansijska sredstva se obezbeđuju shodno zakonskog osnova na snazi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Evidentimi i efekteve dhe reaksioneve anësore të padëshirueshme gjatë transplantimit</p> <p>1. Institucionet shëndetësore te cilat janë te licencuara nga Ministria e Shëndetësisë për transplantimin e organeve janë te obliguara të përcjellin paraqitjen eventuale te reaksioneve dhe efekteve te pa dëshiruara si te dhuruesi ashtu edhe te marrësi, si dhe që për këtë te njoftojnë QSHTK ne baza periodike.</p> <p>2. Institucionet shëndetësore nga paragrafi 1 i këtij neni duhet te mbajnë evidencën mbi çdo reaksion dhe efekt eventual te padeshirushem.</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Registering of adverse side effects or reactions during the transplantation</p> <p>1. Healthcare institutionHealthcare institutions which are licensed by the Ministry of Health for the transplantation of organs are obliged to monitor the eventual appearance of adverse side effects and reactions both to the donor and the recipient, and notify the NTCK hereof periodically.</p> <p>2. Healthcare institutions from paragraph 1 of this article should maintain the records on any possible adverse side effect or reaction.</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Evidentiranje neželjenih pojava efekata i reakcija tokom transplantacije</p> <p>1. Zdravstvene ustanove koje su licencirane od Ministarstva Zdravstva za transplantaciju organa dužne su da prate eventualno pojavljivanje neželjenih pojava i reakcija kako kod davaoca tako i primaoca, i da u vezi toga obavesteDCTK na periodičnim osnovama.</p> <p>2. Zdravstvene ustanove iz stava 1 ovog člana treba da vode evidenciju o svakom eventualnom neželjenom reakcijom i pojavom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Konfidenca profesionale</p> <p>Te gjitha te dhënat e dhuruesit dhe te marrësit konsiderohen konfidencionale. Kjo nuk vlen kur dhuruesi dhe marrësi janë anëtarë te të njëjtës familje.</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Professional confidentiality</p> <p>All the data of the donor and of the recipient shall be considered confidential. This does not apply when the donor and the recipient are members of the same family.</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Profesionalna konfidencialnost</p> <p>Svi podaci o davaocu i primaocu smatraju se konfidencijalnim. To ne važi kada davalac i primalac su članovi iste porodice.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 18 Ndalimi i dhënies se të dhënave</p> <p>1. Ndalohet qe familjes se dhuruesit të vdekur ti jepen te dhëna mbi marrësin.</p> <p>2. Ndalohet që marrësit ti jepen të dhëna mbi dhuruesin e vdekur apo edhe për familjen e tij.</p> <p>3. Ndalohet qe personat te cilët marrin pjese gjatë të gjitha aktiviteteve që lidhen me transplantimin e organeve te japin te dhëna lidhur me dhuruesin dhe marrësin.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Prohibition of giving out information</p> <p>1. Giving out information of the recipient to the family of the deceased donor is prohibited.</p> <p>2. Giving out information of the deceased donor or his family to the recipient is prohibited.</p> <p>3. It is prohibited that the persons who participate in all activities related to the organ transplantation give out information related to the donor and the recipient.</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Zabrana davanja podataka</p> <p>1. Zabranjeno je porodici umrlog davaoca organa davati podatke o ličnosti primaoca organa.</p> <p>2. Zabranjeno je primaocu organa davati podatke umrlog davaoca organa ili njegove porodice.</p> <p>3. Zabranjeno je da lice koji učestvuju u svim postupcima koji se odnose na transplantaciju organa, daju podatke o ličnosti davaoca ili primaoca organa,</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Mundësia e shfrytëzimit te të dhënave</p> <p>Te gjitha të dhënat e dhuruesit dhe marrësit mund te i shfrytëzoj vetëm mjeku kompetent për shkaqë te arsyeshme mjekësore i cili e përcjelle gjendjen e dhuruesit dhe marrësit apo gjatë procedurave gjyqësore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 The possibility to use information</p> <p>All the information of the donor and recipient may be used only by the competent doctor, who supervises the condition of the donor and recipient, due to reasonable medical causes or during court procedures.</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Mogućnost korišćenja podataka</p> <p>Samo nadležni lekar koji prati stanje davaoca i primaoca može da koristi sve podatke davaoca i primaoca za opravdane medicinske svrhe.ili tokom sudskih postupaka</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Të dhënat e dhuruesit dhe te marrësit</p> <p>1. Te dhënat personale të dhuruesit dhe te marrësit i udhëheqë QSHTK, respektivisht institucioni shëndetësor te cilin e ka autorizuar Ministria e Shëndetësisë, për udhëheqjen e punëve të marrjes, tipizimit dhe transplantimit me qëllim mjekimi.</p> <p>2. Të dhënat personale nga paragrafi 1 i këtij neni mund te shfrytëzohen, të shkëmbehen, te</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Information on the donor and recipient</p> <p>1. Personal information of the donor and recipient are managed by the NTCK, respectively the healthcare institution authorized by the Ministry of Health, for the management of the works to take, categorize and transplant for the purpose of medication.</p> <p>2. Personal information from paragraph 1 of this article may be used, exchanged, processed and saved</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Podaci davaoca i primaoca</p> <p>1. Ličnim podacima davaoca i primaoca rukovodi DCTK, odnosno zdravstvena ustanova koju je ovlastilo Ministarstvo Zdravstva, za rukovođenje poslovima uzimnja, tipiziranja i transplantacije radi lečenja.</p> <p>2. Lični podaci iz stava 1 ovog člana mogu se koristiti, razmeniti, obraditi i očuvati u</p>

<p>përpunohen dhe të ruhen në institucionet shëndetësore të cilat Ministria e Shëndetësisë i ka licencuar për të punuar në lidhje me marrjen, transplantimin, tipizimin dhe distribuimin e organeve.</p>	<p>in healthcare institutions licensed by the Ministry of Health licensed to work related to the explantation, transplantation, categorization and distribution of organs.</p>	<p>zdravstvenim ustanovama koje Ministarstvo Zdravavstva je licenciralo da rade u vezi sa uzimanjem, presađivanjem, tipiziranjem i distribuiranjem organa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Mbrojtja e të dhënave</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Data protection</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Zaštita podataka</p>
<p>QSHTK dhe institucionet shëndetësore të cilat janë të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë, konform këtij ligji, janë të obliguar të mbrojnë të dhënat personale.</p>	<p>NTCK and healthcare institutions authorized by the Ministry of Health, in conformity with this Law, are obliged to protect personal data.</p>	<p>DCTK i zdravstvene ustanove koje su ovlašćene od Ministarstva Zdravstva, u skladu sa ovim zakonom, obavezne su da zaštite lične podatke.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 22 Ruajtja e të dhënave</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Data storing</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Čuvanje podataka</p>
<p>1. I gjithë dokumentacioni mjekësor dhe jo mjekësor i dhuruesit dhe marrësit lidhur me transplantimin, arkivohet në institucionin shëndetësor në të cilin është kryer transplantimi konform legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Edhe në rastet kur institucioni shëndetësor përfundon aktivitetin e tij apo humb licencën e punës, ruajtja e të dhënave duhet të bëhet konform legjislacionit në fuqi.</p>	<p>1. The entire medical and non-medical documentation of the donor and recipient related to the transplantation shall be archived in the healthcare institution which performed the transplantation in conformity with the legislation in power.</p> <p>2. Even if the healthcare institution ceases its activity or loses the work license, the storing of data shall be made in conformity with the legislation in power.</p>	<p>1. Celokupna medicinska i ne medicinska dokumentacija davaoca i primaoca u vezi sa transplantacijom, arhivira se u zdravstvenim ustanovama u kojima je izvršena transplantacija u skladu sa zakonom na snazi.</p> <p>2. I u slučajevima kada zdravstvena ustanova završava svoju aktivnost ili gubi licencu za rad, čuvanje podataka treba da se izvrši skladu sa zakonom na snazi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Ndalohet shfrytëzimi të dhënave të dhuruesit dhe marrësit</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 It is prohibited to use the data of the donor and those of the recipient</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Zabranjuje se korišćenje podataka davaoca i primaoca</p>
<p>1. Të dhënat e dhuruesit dhe marrësit nuk mund të</p>	<p>1. The data of the donor and of the recipient may not</p>	<p>1. Podaci davaoca i primaoca ne mogu se koristiti</p>

<p>shfrytëzohen për qëllim shkencore apo te publikohen ne mjetet e informimit nëse ne një mënyrë ose tjetër zbulojnë identitetin e tyre.</p> <p>2. Në raste të veçanta nga paragrafi 1 i këtij neni, te dhënat mund të shfrytëzohen për qëllim shkencore, arsimore dhe statistikore, vetëm pas lejes me shkrim nga dhuruesi dhe marrësi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Pëlqimi me shkrim i marrësit madhor</p> <p>1. Para transplantimit, pavarësisht nga lloji i dhuruesit (i gjallë apo i vdekur) marrësi i moshës madhore detyrimisht duhet te jap pëlqimin me shkrim për transplantim të organit si shprehje e vullnetit te lire. Përmbajtjen e formularit nga paragrafi 1 i këtij neni e përpilon QSHTK, me miratim nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p>2. Specialisti i lëmisë së transplantimit përkatës paraprakisht duhet te njoftoj marrësin mbi procedurën e transplantimit, besueshmërinë e suksesit të transplantimit, pasojat dhe rreziqet eventuale te transplantimit si dhe reaksionet e padëshirueshme eventuale që mund te pasojnë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25</p> <p>1. Pajtimi me shkrim i marrësit nga personi i mitur nga personi që vuan dënimin me burg nga personi me aftësi të kufizuar për pune apo personit me paaftësi psiko-fizike.</p>	<p>be used for scientific purposes or be published in means of information if in any way they uncover their identity.</p> <p>2. In special cases from paragraph 1 of this article, the data may be used for scientific, educational and statistical purposes, only at the written consent of the donor and recipient.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 The written consent of the adult recipient</p> <p>1. Before the transplantation, regardless of the type of donor (deceased or living) the adult recipient must give his written consent for the transplantation of the organs as the expression of his free will. The content of the form from paragraph 1 of this article shall be drafted by the NTCK, at the approval of the Ministry of Health.</p> <p>2. The specialist in the field of relevant transplantation must notify the recipient on the transplantation procedure, reliability of the success of transplantation, possible consequences and risks of transplantation as well as possible adverse reaction that may occur.</p> <p style="text-align: center;">Article 25</p> <p>1. The written consent of the recipient from the underage person, from the person who is imprisoned, from the person with limited work capabilities or the person with psychic – physical disabilities.</p>	<p>za naučne svrhe ili da se objave u sredstvima informisanja ukoliko na neki ili drugi način otkrivaju njihov identitet.</p> <p>2. U posebnim slučajevima iz stava 1 ovog člana, podaci mogu se koristiti za naučne, obrazovne i statističke svrhe, samo posle pismenog odobrenja od davaoca i primaoca.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Pismena saglasnost punoletnog davaoca</p> <p>1. Pre transplantacije, nezavisno od vrste davaoca (živ ili mrtav) punoletni davalac obavezno treba da daje pismenu saglasnost za transplantaciju organa kao izraz slobodne volje. Sadržaj obrazca iz sava 1 ovoga člana sastavlja DCTK, uz odobrenje Ministarstva Zdravstva.</p> <p>2. Specialista iz odgovarajuće oblasti transplantacije prethodno treba da upozna primaoca sa postupkom transplantacije, poverljivosti uspeha transplantacije, eventualne posledice i opasnosti transplantacije kao i eventualne neželjene reakcije koje mogu nastati.</p> <p style="text-align: center;">Član 25</p> <p>1. Pismena saglasnost primaoca od maloletne lice, lice koja izdržava kaznu zatvora, lice s ograničenim sposobnostima za rad ili lice sa psiho-fizičkim nesposobnostima.</p>
--	--	---

<p>2. Personi i mitur, personi ne vuajtje te dënimit me burg, personi me aftësi të kufizuar apo personi me paaftësi psiko-fizike mund të jetë narrës i organit apo pjesëve të organit, me kusht qe para transplantimit paraprakisht të këtë dhënë pëlqimin me shkrim personalisht ose ky pëlqim të jetë dhënë nga familjar të personit apo personat të autorizuar sipas ligjeve në fuqi dhe ky pëlqim të jetë i vërtetuar me vendim gjyqësor nga gjykata kompetente.</p> <p style="text-align: center;">Kreu III THEMELIMI, VEPRIMTARIA DHE ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE NË FUSHEN E TRANSPLANTIMEVE TE ORGANEVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Veprimtaria dhe Organizimi i Institucioneve Shëndetësor të Transplantimeve</p> <p>1. Veprimtaritë, që kryhen gjatë procesit të transplantimit të organeve janë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Promovimi i dhurimit vullnetar dhe të papaguar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Procedura e dhurimit të transplanteve;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Përzgjedhja dhe seleksionimi i dhuruesve;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Procedura e testimit;</p>	<p>2. The underage person, the person who is imprisoned, the person with limited capabilities to work or the person with psychic – physical disabilities may be a recipient of the organ or parts of organs, provided that before the transplantation there was given the written consent personally or this consent was given by a family member of the person or persons authorized according to the Laws in power and this consent shall be verified by a court decision issued by the competent court.</p> <p style="text-align: center;">Chapter III ESTABLISHMENT, ACTIVITY AND ORGANIZATION OF HEALTHCARE INSTITUTIONS IN THE FIELD OF ORGAN TRANSPLANTATION</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Activity and Organization of Healthcare institutions dealing with Transplantations</p> <p>1.The following activities shall be performed during the organ transplantation process:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Promotion of voluntary and unpaid donation;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Transplant donation procedure;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Selection of donors;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Testing procedure;</p>	<p>2. Maloletno lice, lice na izdržavanje kazne zatvora, lice sa ograničenim sposobnostima ili lice sa psiho-fizičkim ogrničenjima može biti primalac organa ili delova organa, pod uslovom da pre transplantacije prethodno dao pismenu saglasnost lično ili ova saglasnost bude data od porodice osobe ili ovlašćene osobe prema zakonima na snazi i ova saglasnost bude overena odlukom suda od nadležnog suda.</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje III OSNIVANJE, DELATNOST I ORGANIZOVANJE ZDRAVSTVENIH USTANOVA U OBLASTI TRANSPLANTACIJA ORGANA</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Delatnost i organizovanje zdravstvenih ustanova transplantacija</p> <p>1. Delatnosti, koje se vrše tokom procesa transplantacije organa su:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Promovisanje dobrovoljnog i bezplatnog doniranja;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Postupak doniranja transplanta;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Odabiranje i selekcija davaoca;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Postupak testiranja;</p>
--	--	---

<p>1.5. Procedura e përpunimit të transplantëve;</p> <p>1.6. Procedura e konservimit dhe ruajtjes së transplantëve;</p> <p>1.7. Procedura e shpërndarjes së transplantëve;</p> <p>1.8. Kryerja e transplantimit;</p> <p>1.9. Procedura e sigurimit të cilësisë.</p> <p>2. Veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni lejohen të kryhen vetëm në institucionet shëndetësore të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p>3. Rregulloret mbi menyren e organizimit dhe funksionimit të veprimtarive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përpilohen nga QSHTK-ja dhe miratohen nga Ministria e Shëndetësisë.</p>	<p>1.5. Transplant processing procedure;</p> <p>1.6. Transplant conservation and preservation procedure;</p> <p>1.7. Transplant distribution procedure;</p> <p>1.8. Transplantation conducting;</p> <p>1.9. Quality assurance procedure.</p> <p>2. The activities noted under item 1 of this article may be performed only in healthcare institutions licensed by the Ministry of Health.</p> <p>3. Regulations on the organization and functioning of the activities determined under item 1 of this article shall be compiled by the NTCK and be approved by the Ministry of Health.</p>	<p>1.5. Postupak obrade transplanta;</p> <p>1.6. Postupak konzerviranja i čuvanja transplanta;</p> <p>1.7. Postupak raspodele transplanta;</p> <p>1.8. Izvršenje transplanta;</p> <p>1.9. Postupak osbezbeđivanja kvaliteta.</p> <p>2. Pomenute delatnosti iz tačke 1 ovog člana dozvoljavaju da se izvrše u zdravstvenim ustanovama licenciranim od strane Ministarstva Zdravstva.</p> <p>3. Pravilnike o načinu organizovanja i funkcionisanja utvrđenih delatosti iz tačke 1 ovog člana, izrađuje DCTK i usvajaju se od strane Ministarstva Zdravstva.</p>
<p>Neni 27</p>	<p>Article 27</p>	<p>Član 27</p>
<p>1. Institucionet shëndetësore në varesi të QSHTK janë:</p> <p>1.1. Qendrat e transplantimeve;</p> <p>1.2. Bankat e organeve;</p> <p>1.3. Laboratori për tipizim.</p> <p>2. Numri i institucioneve shëndetësore të</p>	<p>1. Healthcare institutions depending on the NTCK, are the following:</p> <p>1.1. Transplantation centers;</p> <p>1.2. Organ Banks;</p> <p>1.3. Laboratory for typization.</p> <p>2. The number of healthcare institutions as envisaged</p>	<p>1. Zdravstvene ustanove u zavisnosti od DCTK su:</p> <p>1.1. Centri transplantacije;</p> <p>1.2. Banke organa;</p> <p>1.3. Laboratorij za tipiziranje.</p> <p>2. Broj zdravstvenih ustanova definisano kao u</p>

<p>përcaktuara si në pikën 1 të këtij neni, është i limituar në Kosovë i përcaktuar përmes aktit përkatës nën ligjore.</p> <p>3. Aktin nën ligjore për kushtet që duhet të plotësojë institucioni shëndetësor përkatës në kohën e aplikimit për licencim në Ministrinë e Shëndetësisë si në paragrafin 1 të këtij neni, e harton QSHTK dhe miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.</p>	<p>under item 1 of this article is limited in Kosovo, set out through the relevant byLaw.</p> <p>3. The byLaw on the conditions a relevant healthcare institutions must meet at the time of application for licensing at the Ministry of Health, as noted under paragraph 1 of this article, shall be drafted by the NTCK and be approved by the Minister of Health.</p>	<p>tački 1 ovog člana, je ograničen na Kosovo utvrđen odgovarajućem podzakonskom aktu.</p> <p>3. Podzakonski akt za uslove koje treba da ispunjava odgovarajuća zdravstvena ustanova u vreme aplikacije za licenciranje u Ministarstvu Zdravstva kao u stavu 1 ovog člana, izrađuje DCTK i usvaja se od strane Ministarstva Zdravstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 28</p> <p>Qendra Shtetërore e Transplantimeve e Kosovës</p> <p>1. Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë themelohet Qendra Shtetërore e Transplantimeve e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm QSHTK), për të organizuar dhe koordinuar procesin e transplantimit të organeve.</p> <p>2. QSHTK, kryen këto detyra:</p> <p>2.1. Organizon dhe koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me alokimin e organeve dhe pjesëve të tyre në gjithë territorin e Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. Mban listën shtetërore të pritjes të personave që presin transplantimin e organeve;</p> <p>2.3. Mban listën shtetërore të dhuruesve të transplantëve;</p> <p>2.4. Mban listën shtetërore të</p>	<p style="text-align: center;">Article 28</p> <p>National Transplantation Center of Kosovo</p> <p>1. Within the Ministry of Health there is established the National Transplantation Center of Kosovo (hereinafter referred to as the NTCK), in order to organize and coordinate the organ transplantation process.</p> <p>2. The NTCK, performs also the following duties:</p> <p>2.1. Organises and coordinates all the activities related to the allocation of organs and parts of organs in the entire territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2.2. Maintains the national list of persons waiting for organ transplantations;</p> <p>2.3. Maintains the national list of donors of transplantations;</p> <p>2.4. Maintains the national list of conducted</p>	<p style="text-align: center;">Član 28</p> <p>Državni Centar Transplantacije Kosova</p> <p>1. U okviru Ministarstva Zdravstva osniva se Državni Centar Transplantacija Kosova (DCTK), za organizovanje i koordiniranje transplantaciju organa.</p> <p>2. DCTK, obavlja sledeće zadatke:</p> <p>2.1. Organizuje i koordinira sve aktivnosti u vezi sa lociranjem organa i njihovih delova na na celu teritoriju Republike Kosova.</p> <p>2.2. Vodi državnu listu čekanja osoba koje očekaju transplantaciju organa;</p> <p>2.3. Vodi državnu listu davaoca transplantata;</p> <p>2.4. Vodi državnu listu ostvarenih</p>

<p>transplantimeve të realizuara;</p> <p>2.5. Ndihmon në bashkërendimin e ekipeve të heqjes dhe implantimit të organeve;</p> <p>2.6. Përcakton kriteret për protokollet operative për Qendrat e Transplantimeve të bazuar ekskluzivisht në urgjencë dhe kompatibilitet;</p> <p>2.7. Verifikon aplikimin e kriterëve dhe parametrave sa i përket protokolleve për procedurat e transplantimit të organeve;</p> <p>2.8. Përcakton parametrat për verifikimin e kualitetit dhe rezultateve të Qendrave të Transplantimeve;</p> <p>2.9. Cakton përfituesit më të përshtatshëm, bazuar në rezultatet e analizave të tipizimit indor;</p> <p>2.10. Përzgjedhja e përfituesve realizohet vetëm nga lista shtetërore e pritjes për transplantimin e organeve;</p> <p>2.11. Përpunon të dhëna të përgjithshme për eksplantimet dhe implantimet të realizuara. Njëkohësisht përpunon rezultatet e tyre për vitin pararendës dhe harton raporte periodike për Ministrinë e Shëndetësisë dhe sipas kërkesës edhe më shpesh;</p> <p>2.12. Vendos dhe koordinon bashkëpunimin ndërkombëtar në shkëmbimin e organeve për transplantim;</p>	<p>transplantations;</p> <p>2.5. Assists in coordinating teams for the explantation and implantation of organs;</p> <p>2.6. Determines the criteria for operative protocols for Transplantation Centers based exclusively on urgency and compatibility;</p> <p>2.7. Verifies the application of criteria and parameters with regard to protocols for organ transplantation procedures;</p> <p>2.8. Determines the parameters for the verification of the quality and results of the Transplantation Centers;</p> <p>2.9. Determines the most compatible recipient, based on the results of tissue typization analysis;</p> <p>2.10. The selection of beneficiaries shall be realized only from the national organ transplantation waiting list;</p> <p>2.11. Processes the general data for realized explantations and implantations. Also, it processes their results for the previous year and drafts periodic reports for the Ministry of Health, and if requested even more frequent;</p> <p>2.12. Decides and coordinates the international cooperation in exchange of organs for transplantation;</p>	<p>transplantacija;</p> <p>2.5. Pomaže koordiniranje ekipa uzimanja i presađivanja organa;</p> <p>2.6. Utvrđuje kriterijume operative protokole za centre transplantacija baziranih isključivo na hitnost i kompatibilnost;</p> <p>2.7. Proverava primenu kriterijuma i parametre što se tiče protokola za procedure transplantacije organa;</p> <p>2.8. Utvrđuje parametre za proveravanje kvaliteta i rezultata centara transplantacija;</p> <p>2.9. Određuje najpristupačne, bazirane na razultatima analiza tkivnog tipiziranja;</p> <p>2.10. Odabiranje korisnika se ostvaruje samo iz državne liste čekanja za transplantacije organa;</p> <p>2.11. Obraduje opšte podatke za ostvarene eksplantacije i implantacije. Ujedno obraduje njihove rezultate za prethodnu godinu i izrađuje periodične izveštaje za Ministarstvo Zdravstva prema zahtevima i češće;</p> <p>2.12. Odlučuje i koordinira međunarodnu saradnju za razmenu organa za transplantaciju;</p>
---	---	--

<p>2.13. Bën alokimin e organeve të dhuruesve të vdekur në bazë të kritereve të definuara në ligj dhe në aktet nën-ligjore;</p> <p>2.14. Publikon raporte periodike mbi listën e pritjes, dhuruesit, transplantimet e kryera, dhe informata të tjera të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë;</p> <p>2.15. Ruan të dhënat përkitazi me alokimin e organeve dhe pjesëve të tyre për periudhën kohore të përcaktuar me akt nën-ligjor.</p> <p>3. QSHTK, udhëhiqet nga drejtori i cili duhet të ketë eksperienc në fushën e transplantimeve, i cili është anëtar i Bordit dhe i cili propozohet nga Bordi i QSHTK dhe zgjidhet nga Ministri i Shëndetësisë.</p> <p>4. Anëtarët e Bordit të QSHTK përzgjidhen me konkurs publik dhe duhet të kryejnë detyrat e QSHTK sipas paragrafi 2 i këtij neni.</p> <p>5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të QSHTK, rregullohet me akt të veçantë nën ligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Qendrat e transplantimeve dhe Laboratori për tipizim</p> <p>1. Qendrat që kryejnë transplantime të organeve</p>	<p>2.13. Allocates the organs of deceased donors based on the criteria defined by Law and byLaws;</p> <p>2.14. Publishes periodic reports on the waiting list, the donors, conducted transplantations and other information as determined by the Ministry of Health;</p> <p>2.15. Preserves the information in accordance with the allocation of organs and parts of organs for the time period as envisaged by means of a byLaw.</p> <p>3. NTCK shall be managed by the director who should have experience in the field of transplantations, who is a member of the Board and who shall be proposed by the Board of NTCK and be appointed by the Minister of Health.</p> <p>4. The NTCK Board Members shall be selected by means of a public competition and shall perform the duties of the NTCK according to paragraph 2 of this article.</p> <p>5. The internal organization and functioning of the NTCK shall be regulated by means of a special byLaw.</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Transplantation Centers and Typization Laboratory</p> <p>1. The centers performing transplantations of organs</p>	<p>2.13. Vrshi lociranjë organa umrlih davaoca na osnovu definisinanih kriterijuma u zakonu i u pod-zakonskim aktima;</p> <p>2.14. Objavljuje periodične izveštaje liste čekanja,davaoçe,ostvarene transplantacije, i druge informacije utvrđene od strane Ministarstva Zdravstva;</p> <p>2.15. Sačuva podatke u vezi sa lociranjem organa i njihovih delova za utvrđeni vremenski period utvrđen pod-zakonskim aktom.</p> <p>3. DCTK, upravlja se od direktora koji treba da ima iskustvo u oblasti transplantacija, koji je član Odbora i koji predlaže Odboru i DCTK i bira se od strane Ministra Zdravstva.</p> <p>4. Članovi Odbora DCTK se biraju javnim konkursom i treba da obavljaju zadatke DCTK prema stavu 2 ovog člana.</p> <p>5. Način unutrašnjeg organiizovanja i funkcioniranja DCTK, reguliše se posebnim pod-zakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Centri transplantacija i Laboratorij za tipiziranje</p> <p>1. Centri koji izvršavaju transplantaciju organa ili</p>
--	---	---

<p>apo pjesëve të organeve, quhen Qendra të Transplantimit. Në kuader të qendrave të transplantimit si njesi e veçant, mund të funksionoj edhe laboratorit për tipizim.</p> <p>2. Këto qendra formohen dhe krijohen, sipas lemive të caktuara në momentin kur janë plotësuar të gjitha kushtet dhe mundësitë për realizimin e transplantimeve dhe pas licencimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.</p> <p>3. Qendrat e transplantimit, realizojnë heqjen dhe implantimin e organeve në bazë të këtij ligji.</p> <p>4. Të gjitha Qendrat e transplantimeve kryejnë këto detyra:</p> <p>4.1. Raportojnë për personat me indikacione për transplantim të QSHTK;</p> <p>4.2. Kryejnë implantimin vetëm për përfituesit e regjistruar në listën shtetërore të personave që presin për transplantimin e organeve;</p> <p>4.3. Raportojnë për transplantimet e realizuara pranë QSHTK përfshirë publikimin e rregullt të rezultateve të transplantimeve;</p> <p>4.4. Definojnë kriteret standarde për analizim dhe publikim.</p> <p>4.5. Bashkëpunojnë me QSHTK, për të caktuar përfituesit më të përshtatshëm të</p>	<p>or parts of organs are called Transplantation Centers. Within the transplantation centers as a special unit, there may functionalize also the typization laboratory.</p> <p>2. These centers shall be formed and created according to the relevant fields at the moment when there are met all the requirements and possibilities to realize transplantations and after licensing by the Ministry of Health.</p> <p>3. The transplantation centers conduct the explantation and implantation of organs based on this Law.</p> <p>4. All the transplantation centers shall perform the following duties:</p> <p>4.1. Reports on persons with indications for transplantation at the NTCK;</p> <p>4.2. conduct the transplantation only for the beneficiaries registered in the national list of persons waiting for organ transplantation;</p> <p>4.3. Report on transplantations realized at the NTCK including the regular publishing of results and transplants;</p> <p>4.4. Define the standard criteria for analyzing and publishing;</p> <p>4.5. Cooperate with the NTCK, in order to select the most compatible beneficial of the</p>	<p>delova organa, nazivaju se centri transplantacija. U okviru centara transplantacija kao posebna jedinica, može da funkcioniše i laboratorij za tipiziranje.</p> <p>2. Ovi centri se formiraju i stvaraju, prema određenim oblastima u momentu kada su ispunjeni svi uslovi i mogućnosti za ostvarivanje transplantacija i posle licenciranja od strane Ministarstva Zdravstva.</p> <p>3. Centri transplantacija, ostvarju uzimanje i implantaciju organa na osnovu ovog zakona.</p> <p>4. Svi centri transplantacija obavljaju sledeće zadatke:</p> <p>4.1. Izveštavaju o licima sa indikacijama za transplantaciju kod DCTK;</p> <p>4.2. Izvršavaju implantaciju samo za registrovane korisnike iz državne liste osoba koji čekaju za trnsplantaciju organa;</p> <p>4.3. Izveštavaju ostvarene transplantacije pri DCTK uključujući redovno objavljivanje rezultata transplantacija;</p> <p>4.4. Definišu standardne kriterijume za analiziranje i objavljivanje;</p> <p>4.5. Saraduju sa DCTK, radi određivanja podobnog korisnika organa ili delova</p>
--	--	---

<p>organeve apo pjesëve te organeve;</p> <p>4.6. Informojnë QSHTK për dhuruesin/marrësin e mundshëm;</p> <p>4.7. Sigurojnë të dhëna që kërkohen nga QSHTK, lidhur me organet apo pjesët e organeve.</p> <p>4.8. Të dhënat e siguruara e ruajnë anonimitetin në mënyrë të tillë që si dhuruesi ashtu edhe përfituesi të mos identifikohen;</p> <p>4.9. Dokumentojnë me shkrim përdorimin e organeve apo pjesëve te organeve të hequra, në protokoll i cili i bashkëlidhet dokumenteve të tjera shoqëruese për transplantin e hequr. Ky protokoll përmban veçanërisht datën dhe vendin e heqjes, si dhe qëllimin përfundimtar të transplanteve të hequra;</p> <p>4.10. Në rast se merret një vendim që organet apo pjesët e organeve te hequra janë të papërshtatshme, arsyeja e mos-përshtatshmërisë, si dhe mënyra e trajtimit të mëtejshëm të tyre shënohen në protokoll;</p> <p>4.11. Ruajnë të dhëna për heqjet dhe implantimet e realizuara dhe shënojnë të dhënat për organet e hequra në protokoll.</p> <p>4.12. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të brendshëm te Qendrave te</p>	<p>organs or parts of organs;</p> <p>4.6. Notify the NTCK on the possible donor/recipient;</p> <p>4.7. Provide the data required by the NTCK, related to the organs or parts of organs;</p> <p>4.8. The provided data shall maintain its anonymity so that the donor and the recipient be not identified;</p> <p>4.9. Document in writing the use of organs or parts of organs removed, in the protocol enclosed to other associating documents on the removed transplant. This protocol contains in particular the date and location of removal as well as the final purpose of the removed transplants;</p> <p>4.10. In case there is taken a decision that the organs or parts of organs removed, are incompatible, the reason of incompatibility as well as the manner of their further treatment shall be written down in the protocol;</p> <p>4.11. Maintain the data for the realized explantations and implantations and write down the data on the removed organs in the protocol.</p> <p>4.12. The manner of internal organization and functioning of the Transplantation Centers,</p>	<p>organa;</p> <p>4.6. Nformišu DCTK za mogućeg davaoca/primaoca;</p> <p>4.7. Obezbeđuje podatke koja se traže od DCTK, u vezi sa organima ili njihovim delovima;</p> <p>4.8. Obezbeđeni podaci sačuvaju anonimnost kako ni davalac ni primalac ne bi bili identifikovani;</p> <p>4.9. Pismeno dokumentiraju upotrebu organa ili delova uzetih organa, u protokolu koji se priloži drugim pratećim dokumentima za uklonjeni transplant. Ovaj protokol sadrži naročito datum i mesto uzimanja, kao i krajni cilj uzetih transplanta;</p> <p>4.10. U slučaju da se donosi neka odluka da organi ili delovi uzetih organa su nepristupačni, razlog ne-pristupačnosti, kao i način daljeg njihovog tretiranja evidentuje se u protokolu;</p> <p>4.11. Čuvaju podatke o ostvarenim uklanjanjima i implantacija i beleže podake uklanjanja u protokolu;</p> <p>4.12. Način organizovanja i unutrašnjeg funkcionisanja centara za transplantaciju, uslove i kriterijume koje treba da ispuni</p>
--	--	---

<p>Transplanteve, kushtet dhe kriteret që duhet ti plotesoj institucioni qe aplikon për licencim, rregullohet me akt të veçantë nën ligjor.</p> <p>5. Laboratori për tipizim mund të funksionoj edhe si institucion i pavarur nga qendra e transplantimeve, siç parashihet edhe në nenin 27 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas legjislacionit ne fuqi.</p> <p>5.1. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të brendshëm te laboratorit për tipizim, kushtet dhe kriteret që duhet ti plotesoj institucioni qe aplikon për licencim, rregullohet me akt të veçantë nën ligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Banka e organeve</p> <p>1. Banka e organeve apo pjesëve të organeve është strukturë shëndetësore e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë që i përgjigjet QSHTK dhe kryen veprimtaritë e mëposhtme;</p> <p>1.1. Konservimin, ruajtjen, etiketimin dhe paketimin e organeve dhe dokumentimin e të dhënave për to;</p> <p>1.2. Shpërndarjen e organeve të destinuara për transplantim.</p> <p>2. Banka e organeve ka për detyrë si në vijim;</p>	<p>the conditions and requirements that shall be met by the institution applying for licensing shall be regulated by means of a special byLaw.</p> <p>5. The Typization laboratory may function also as an institution independent from the transplantation center , as noted under article 27 paragraph 1, subparagraph 1.3 licensed by the Ministry of Health according to the Legislation in power.</p> <p>5.1. The manner of internal organization and functioning of the Typization Laboratory, the conditions and requirements that shall be met by the institution applying for licensing shall be regulated by means of a special byLaw.</p> <p style="text-align: center;">Article 30 Bank of organs</p> <p>1. The bank of organs or parts of organs is a health structure licensed by the Ministry of Health which reports to the NTCK and conducts the following activities:</p> <p>1.1. Conservation, preservation, labeling and packaging of organs and documentation of the data thereto;</p> <p>1.2. Distribution of organs destined for transplantation.</p> <p>2. The bank of organs has the following duties:</p>	<p>ustanova koja aplikuje za licenciranje, reguliše se posebnim podzakonskim aktom.</p> <p>5. Laboratorij za tipiziranje može da funkcioniše i kao smostalna ustanova nezavisna od centra za transplantaciju, kao što je predviđeno u članu 27 stav 1 podstav 1.3 licenciran od strane Ministarstva Zdravstva u skladu sa zakonom na snazi.</p> <p>5.1. Način organizovanja i unutrašnjeg funkcionisanja laboratorija za tipiziranje, uslove koje treba da ispuni ustanova koja aplikuje za licenciranje, reguliše se posebnim podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 30 Banka organa</p> <p>1. Banka organa ili delova organa je zdravstvena struktura licencirana od strane Ministarstva Zdravstva koja odgovora DCTK i obavlja sledeće delatnosti:</p> <p>1.1. Konzervisanje, očuvanje, etiketiranje i paketiranje i dokumentiranje podataka za iste;</p> <p>1.2. Raspodeljivanje organa namenjenih za transplantaciju.</p> <p>2. Banka organa ima sledeće zadatke:</p>
---	---	---

<p>2.1. Zbaton vendimet dhe rekomandimet e QSHTK;</p> <p>2.2. Bashkëpunon me qendrat e transplantimit, departamentet e patologjisë, mjekësisë ligjore, Laboratorin për tipizim dhe me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës.</p> <p>2.3. Mban të dhëna për veprimtaritë e saj, përfshirë llojin dhe sasinë e transplanteve të konservuara, të përpunuara, të ruajtura e të shpërndara për Qendrat e Transplantimeve;</p> <p>2.4. Mban të dhëna për ekzaminimet e realizuara të dhuruesve të mundshëm të organeve;</p> <p>2.5. Raporton ne baza periodike apo sipas kërkesës për QSHTK.</p> <p>3. Banka themelohet me propozim nga QSHTK dhe me miratim nga Ministri i Shëndetësisë.</p> <p>3.1. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të brendshëm e Bankave të organeve, kushtet dhe kriteret që duhet të plotesoj institucioni që aplikon për licencim, rregullohet me akt të posaçëm nën ligjor.</p>	<p>2.1. Implements the decisions and recommendations of the NTCK;</p> <p>2.2. Cooperates with the transplantation centers, the departments of pathology, forensics, the laboratory for typization and the National Blood Transfusion Center of Kosovo;</p> <p>2.3. Maintains the information for its activities, including the type and amount of transplants conserved, processed, preserved and distributed to Transplantation Centers;</p> <p>2.4. Maintains the information for examinations conducted for possible organ donors;</p> <p>2.5. Reports periodically or at the request of the NTCK.</p> <p>3. The bank is established at the proposal of the NTCK and with the approval of the Minister of Health.</p> <p>3.1. The method of internal organization and functioning of the Banks of organs, the conditions and requirements that shall be met by the institution applying for licensing shall be regulated by means of a special byLaw.</p>	<p>2.1. Sprovodi odluke i preporuke DCTK;</p> <p>2.2. Saraduje s centrima transplantacija, patološkim departmentima, sudskom medicinom, Laboratorijom za tipiziranje i Nacionalnim centrom za transfuziju krvi Kosova;</p> <p>2.3. Vodi podatke za njene delatnosti, ulljučijući vrstu i količinu konzervisanih, obrađenih, ne obrađenih, sačuvanih i raspodeljenih transplanata za centre transplantacija;</p> <p>2.4. Vodi podatke za realizovana ispitivanja mogućih donatora organa;</p> <p>2.5. Izveštava periodično ili na zahtev DCTK.</p> <p>3. Banka se osniva na predlog DCTK i sa odobrenjem od strane Ministra Zdravstva.</p> <p>3.1. Način unutrašnjeg organizovanja i funkcionisnja banaka organa, uslove i kriterijume koji treba da ispuni ustanova koja aplikuje za licenciranje, reguliše se posebnim podzakonskim aktom.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 31 Komiteti i Etikës Mjekësore për Transplantime</p>	<p align="center">Article 31 Committee of Medical Ethics for Transplantations</p>	<p align="center">Član 31 Komitet medicinske etike za transplantacije</p>
<p>1. Komiteti i Etikës Mjekësore për Transplantime, sipas detyrimeve të këtij ligji, trajton çështje të transplantimit të organeve dhe pjesëve të organeve.</p> <p>2. Komiteti i Etikës Mjekësore për Transplantime, është strukture ne përbërjen e QSHTK dhe i përgjigjet QSHTK.</p> <p>3. Komiteti i Etikës Mjekësore për Transplantime, përcakton parimet themelore të etikës profesionale te punonjësve shëndetësor që merren me procesin e transplantimit.</p> <p>4. Komiteti i Etikës Mjekësore për Transplantime, përpilon rregullore te detajuar te punës se saj që miratohet nga Ministria e Shëndetësisë përmes QSHTK.</p> <p>5. Anëtarët e Komitetit i Etikës Mjekësore për Transplantime, nuk duhet të jenë në konflikt interesi me pozicionin e tyre të punës. Ata nuk duhet të jenë pjesë e stafit mjekësor që merr pjesë në procesin e transplantimit.</p> <p>6. Komiteti i Etikës Mjekësore për Transplantime vendos për të gjitha çështjet kontestuese etike që lidhen me procesin e transplantimit.</p> <p>7. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore për Transplantime, ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave që kanë mësuar gjatë shqyrtimit të</p>	<p>1. The Committee of Medical Ethics for Transplantations, according to the requirements of this Law, takes care of the issues of transplantations of organs or parts of organs.</p> <p>2. The Committee of Medical Ethics for Transplantation is a structure in the composition of the NTCK and reports to the NTCK.</p> <p>3. The Committee of Medical Ethics for Transplantations determines the basic principles of professional ethics of health workers dealing with the transplantation process.</p> <p>4. The Committee of Medical Ethics for Transplantations drafted its detailed work relations which shall be approved by the Ministry of Health, through the NTCK.</p> <p>5. The Members of the Committee of Medical Ethics for Transplantations shall not be in conflict of interest with their working position. They shall not be part of the medical personnel that participates in the transplantation process.</p> <p>6. The Committee of Medical Ethics for Transplantations decides on all ethical disputes related to the transplantation process.</p> <p>7. The members of the Committee of Medical Ethics for Transplantation shall protect the confidentiality of all the information they learned during the</p>	<p>1. Komitet medicinske etike za transplantacije, prema obavezama ovog zakona, rešava pitanja transplantacije organa i delova organa.</p> <p>2. Komitet medicinske etike za transplantacije je struktura u okviru DCTK i odgovara DCTK.</p> <p>3. Komitet medicinske etike za transplantacije, utvrđuje osnovna načela profesionalne etike zdravstvenih radnika koji se bave procesom transplantacije.</p> <p>4. Komitet medicinske etike za transplantacije, izrađuje detaljan pravilnik njegovog rada koji se usvaja od strane Ministarstva Zdravstva preko DCTK.</p> <p>5. Članovi medicinske etike za transplantacije, ne treba da budu u sukobu interesa sa njihovim radnim mestima. Oni ne treba da budu deo medicinskog osoblja koji učestvuje u procesu transplantacije.</p> <p>6. Komitet medicinske etike za transplantacije odlučuje za sva sporna pitanja u vezi sa procesom transplantacije.</p> <p>7. Članovi Komiteta medicinske etike za transplantacije, sačuvaju poverljivost svih podataka do koje su došli razmatrajući</p>

dokumentacionit gjatë detyrës zyrtare, me përjashtim të rasteve kur të dhënat bëhen të njohura me pëlqimin e dhuruesit, përfituesit ose të përfaqësuesit të tyre ligjor. Sigurimi i një pëlqimi apo refuzimi të tillë, bëhet pjesë e të dhënave mjekësore të dhuruesit përkatesish të përfituesit madhor, të miturit, ose personit të paaftë për të shprehur pëlqimin e tij/saj.

Kreu IV
MARRJA E ORGANEVE APO PJESEVE
TE ORGANEVE NGA PERSONAT TEK
TE CILET ËSHTË VERIFIKUAR
VDEKJA E TRURIT

Neni 32
Verifikimi i vdekjes se trurit

1. Marrja e organit nga personi i vdekur me qëllim transplantimi te personi tjetër, mund të behet ekskluzivisht vetëm pas diagnostikimit dhe verifikimit të vdekjes se trurit bazuar në kriteriumet mjekësore.
